

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 32 dhe 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta zyrtare e RMV” nr.14/2022 të datës 20.01.2022), duke shqyrtuar mbi referatin e përgatitur për çështjen juridike, të iniciuar nga këshilli i ankesave – “Nëse kur parashtrues të kërkesës për gjykim në afat të arsyeshëm janë më shumë persona, të cilëve cilësia e palës në procedurën e falimentimit u është konstatuar me aktvendim për falimentim si “GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE” si një kreditor, me shumën totale të kërkesës, dhe jo sipas emrit, kompensimi i drejtë duhet të përcaktohet në shuma individuale ose kolektive, si për një kërkesë përkatësisht palë”, në seancën e mbajtur më 18.04.2022, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Kur parashtrues të kërkesës për gjykim në afat të arsyeshëm janë më shumë persona, të cilëve cilësia e palës në procedurën e falimentimit u është konstatuar me aktvendim për falimentim si një kreditor, me shumën totale të kërkesës, dhe jo në mënyrë individuale përkatësisht të theksuar me emër, kompensimi i drejtë për shkak të shkeljes së përcaktuar më parë të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, do të shqiptohet në shuma individuale, për çdo parashtrues të legjitimuar veçmas.

A r s y e t i m

Duke vepruar mbi iniciativën e këshillit të ankesave, që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, shqyrtoi mbi çështjen juridike të referatit të përgatitur, të gjyqarit - referues të lëndës.

Për kërkesa të parashtruara për gjykim në afat të arsyeshëm nga të punësuarit e Shoqërisë Ç. SHA eksport-import K, përmes të autorizuarit D.Ç.G., avokat nga S., Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për përputhshmërinë në kuptim të nenit 36 nga Ligji për gjykata (Gazeta Zyrtare e RM nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), në bazë të të dhënave në kërkesën dhe këqyrjen në shkresat e lëndëve, vendosi që lëndët PSSRG.nr.....,PSRRG.nr.....,PSRRG.nr.....,PSRRG.nr.....,PSRRG.nr....., PSRRG.nr....., PSRRG.nr..... të bashkohen dhe për të njëjtat të vendoset me një aktvendim PSRRG.nr....., për shkak se kërkesat janë për një bazë të njëjtë juridike, përkatësisht bëhet fjalë për lëndë për falimentim ku parashtruesit paraqiten si kreditor për falimentim.

Me aktvendim të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut PSRRG.nr..... nga viti, kërkesa e gjithsej 427 parashtruesve të theksuar në aktvendim, aprovohet. Konstatohet shkelja e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në procedurën e lëndës St.nr.75/13 të Gjykatës Themelore Shtip (më parë St.nr.239/03 të Gjykatës Themelore Kumanovë). Përcaktohet afati prej nëntë muajve, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit të plotfuqishëm, ku Gjykata Themelore Shtip të përfundojë procedurën e lëndës St.nr.75/13. Shqiptohet kompensim i drejtë i parashtruesve të kërkesës për shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shumë totale prej 427.000,00 denarë, që duhet të paguhet në afat prej tre muaj pasi aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Kundër aktvendimit të shkallës së parë PSRRG.nr....., autorizuesi i parashtruesve, më 23.11.2021 në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka paraqitur ankesë, për shkeljen thelbësore të procedurës, për gjendjen faktike të konstatuar gabimisht dhe jo në tërësi, zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet, aktvendimi në fjalë, të ndryshohet në mënyrë që do të shqiptohet kompensim i drejtë në lartësi me nga 600.000,00 denarë, në mënyrë individuale për çdo parashtrues.

Në arsyetimin e ankesës theksohet se Gjykata Supreme në aktvendimin ankimor nuk e konteston cilësinë e palëve në procedurën e 427 parashtruesve, tani ankues, por se kontestuese është ajo që kërkesa e tyre konsiderohet kolektive dhe me atë tentohet ta arsyetojë kompensimin e drejtë të ulët, me ç' rast me qëllim dëmtohen parashtruesit. Në vazhdim, duke dhënë arsyetim të vetin kundër këtij qëndrimi të shprehur të Gjykatës Supreme, autorizuesi thërritet në praktikën gjyqësore, duke theksuar aktvendime konkrete që kanë të bëjnë me lëndët e M.F. dhe T. si dhe lëndët nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke vepruar për ankesën në fjalë, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është formuar lëndë, për të cilën shqyrtoi këshilli gjykues.

Duke vërejtur ankesën dhe specifikat e çështjes juridike, në seancën e mbajtur më 09.03.2021, Këshilli vendosi që kjo çështje juridike të shqyrtohet në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, që të merret qëndrim konkret.

Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar mbi çështjen e parashtruar juridike, miratoi këtë mendim juridik, për ekzistimin e arsyeve si vijon:

Këshilli i shkallës së parë gjatë vendimmarrjes për kërkesën e parashtruar për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, pas konstatimit të shkeljes së nenit 6 paragrafi 1 të GJEDNJ, përkatësisht shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, mbi procedurën konkrete dhe gjatë përcaktimit të kompensimit të drejtë në shumë totale prej 427.000,00 denarë për të gjithë parashtruesit së bashku, ka pas parasysh se fletëparaqitja për kërkesën për falimentim të datës 11.12.2003, drejtuar Drejtorit të falimentimit ka qenë e parashtruar nga KREDITORI: Të punësuarit e Ç.SHA(950 të punësuarve), ndër të cilët janë edhe 427 parashtrues. Me aktvendim të Gjykatës Themelore Kumanovë St.nr.239/03 të datës 14.01.2004, me numër rendor 83, është konstatuar kërkesë në procedurën për falimentim në lartësi prej 310.334.110,00 denarëve si kërkesë e një kreditore - "GRUP I 950 TË PUNËSUARVE" (pa u theksuar me emra dhe mbiemra veç e veç). Në Tabelën (shemë) e kërkesave të konstatuara të DPTU Ç. SHA eksport – import K. në falimentim, të cilën Drejtori i falimentimit e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore Shtip më 27.01.2020, nën numrin rendor 79, është konstatuar kërkesë e një Kreditore – 83. GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE. Në parashtruesin për rregullimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm PSRRG.nr..... viti, nga autorizuesi i 427 parashtruesve, nga 01.07.2021, është theksuar se kërkesat e të punësuarve kreditorë të falimentimit, ndër të cilët edhe 427 tani parashtrues të kërkesës, dukshëm nga aktvendimi i Gjykatës St.nr.239/03 të datës 14.01.2004, JANË KONSTATUAR SI KOLEKTIVE edhe atë si kreditor të falimentimit "GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE" në lartësi prej 310.334.110,00 denarëve, dhe jo në mënyrë individuale me emër, mbiemër dhe lartësi të kërkesave të tyre të konstatuara individuale. Ajo që me aktvendimet e Gjykatës Themelore Kumanovë St.nr.239/03 të datës 14.01.2004 dhe St.nr.239/03 të datës 06.09.2005, me të cilat janë konstatuar kërkesat e kreditorëve, janë

konstatuar edhe kërkesat me emrat e të punësuarve të debitori i falimentimit, ndër të cilët edhe të disave nga 427 parashtruesve, nuk e ndryshon faktin se të drejtën për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm për procedurën e lëndës St.nr.75/13 të Gjykatës Themelore Shtip, parashtruesit e nxjerrin nga cilësia e palës në procedurë falimentimi, kërkesa e të cilëve është konstatuar si kërkesë e njërit kreditor edhe atë nën “GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE”.

Ky sektor, konsideron se këshilli i shkallës së parë e ka konstatuar me të drejtë gjendjen faktike kur ka konstatuar shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në procedurën konkrete, por gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale gjatë përcaktimit të statusit të parashtruesve të kërkesës, si dhe lidhur me gjithsej kompensimin e përcaktuar në para për të gjithë parashtruesit.

Këshilli i shkallës së parë, me pranimin e rregullimit të kërkesave të tani parashtruesve me kërkesat e parashtruara individuale për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe ndarjen e tyre nga gjithsej grupi i kreditorëve “GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE”, e pranon cilësinë individuale të palëve në procedurën e 427 parashtruesve, tani ankues, megjithatë, kompensimin e tyre në para, për shkak të shkeljes së konstatuar për të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm, e përcakton në shumë totale për të gjithë parashtruesit së bashku.

Në përputhje me praktikën e kësaj Gjykate, kur kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është parashtruar nga më shumë parashtrues, gjatë shkeljes së konstatuar për gjykim në afat të arsyeshëm, kompensimi i drejtë do të shqiptohet në shumë individuale për çdo parashtrues veç e veç. Ajo që këshilli i shkallës së parë ka bërë individualizimin e parashtruesve të kërkesës nga kreditori, i emëruar si “GRUPI I 950 TË PUNËSUARVE”, përkatësisht me kërkesat për rregullimin, parashtruesit e kërkesave ishin veç e veç dhe në mënyrë individuale të identifikuar me letër njoftim, paraqet individualizimin e kërkesave të tyre për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nga grupi i 950 kreditorëve në procedurën e falimentimit. Duke marrë parasysh se, kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm duhet të përfshijë të dhënat e çdo parashtruesi të kërkesës veç e veç, që në fakt është dorëzuar nga parashtruesit me rregullimin e kërkesës, paraqet individualizimin e parashtruesve nga grupi i kreditorëve.

Nga e ekspozuara del se, kur parashtruesit e kërkesës për gjykim në afat të arsyeshëm janë më shumë persona, të cilëve cilësia e palës në procedurën e falimentimit u është përcaktuar me aktvendim për falimentim si një kreditor, me shumën totale të kërkesës, e jo të theksuar veç e veç dhe me emër, kompensimi i drejtë për shkak të shkeljes së konstatuar më parë e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, duhet të jetë i konstatuar në shuma të ndara, për çdo parashtrues të legjitimuar veç e veç.

Spektori për gjykim në afat të arsyeshëm